

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Në Tirnaë, sot më datë 26.02.2022, u paraqitën personalisht palët:

- 1- Z. Orion Marku, shtetas shqiptar, lindur më 29/10/1980, ne Rreshen dhe banues në Tirane, në Njesia Bashkiake Nr.9, Rr.Karl Gega, Nr.11 H.7 Ap.10, me numër karte identiteti 031661266, madhor me zotesi te plotë pët të vepruar, zotërues i 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, ketu me poshte cilesuar si **pala shitese**
- 2- Z. Altin Furtuna, shtetas shqiptar, lindur më 09/01/1979, ne Burrel dhe banues në Tirane, në Njesia Bashkiake Nr.2, Rr.Mihal Grameno, Pall.8, Ap.17, me numër karte identiteti 027157836, madhor me zotesi te plotë pët të vepruar, zotërues i 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, ketu me poshte cilesuar si **pala blerese**

Palët e mësipërme redaktuan kete kontrate shitje kuotash si më poshtë:

Kushte paraprake:

1. Pala shitëse në bazë të Ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, është ortak me 1 pjesë e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë “**RocknWorks**” SHPK, e rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 18.05.2018 me Nipt L81718029L.
2. Kapitali te shoqërisë 100.000 lekë, dhe pala shitëse është zotërues i 1 pjese e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.
3. Pala shitese ka vendosur, me vendimin Nr. 1 date 26.02.2022, t`l transferojë palës blerëse nëpërmjet shitjes 50% te kuotave pales blerëse Altin Furtuna, duke u bërë pala blerëse pronare me 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Neni 1 – Baza ligjore

Kjo kontratë lidhet në bazë të nenit 705 e vijues të Kodit Civil Shqiptar, Nnit 73, Paragrafi 1, shkronja c e ligjit nr 9901, datë 14.04.2008 (Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare) I ndryshuar.

Neni 2 - Objekti I Kontratës

Pala shitëse, transferon me anë të kësaj kontrate, me vullnet të lirë e të plotë në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 (Për Tregtarët dhe shoqërite tregtare) dhe Statutit të Shoqërisë, 50% të kuotave me vlere të përgjithshme 50.000 lekë (pesedhjetemije leke) palës blerëse, të kapitalit të shoqërisë “**RocknWorks**” SHPK.

Neni 3 – Cmimi I shitjes dhe mënyra e likuidimit

Cmimi i shitjes së 50% te kuotave që zotëron pala shitëse në shoqërinë “**RocknWorks**” SHPK dhe që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate në favor të blerësit në masën 50% për blerësin e

mësipërm në vlerën 50.000 lekë (pesedhjetemijë) lekë. Cmimi i blerjes është paguar nga blerësi dhe pala shitëse deklaron se pala blerëse nuk ka asnjë detyrim financiar kundrejt tij, pasi është likujduar tërësisht për të gjithë shumën.

Neni 4 – Garancitë

Pala shitëse deklaron dhe garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i pjesëve që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga cdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Neni 5 – Heqja dorë nga të drejtat

Pala Shitëse deklaron nën përgjegjësinë personale, se heq dorë nga 50% te kuotave te kapitalit që i takojnë në cilësinë e ortakut të shoqërisë në lidhje me pjesët që transferon, pas nënshkrimit të kësaj kontrate duke ngulur ortak i vetem pala blerëse për 100% te kuotave te kapitalit te shoqërisë.

Neni 6- Efekte ligjore

1. Pas realizimit të këtij transferimi, me nënshkrimin e kësaj kontrate :
Z. Altin Furtuna është ortak i vetem i 100% të kapitalit të shoqërisë
2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala shitëse humbet çdo të drejtë pronësie mbi 50 % te pjeses pjesët e kapitalit që transferon, të drejta te cilat janë transferuar tek pala blerëse.

Neni 7- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo lloj mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palevë, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Kjo kontrate u hartua në 4 (kater) ekzemplare me vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, të cilat deklaruan se e kuptuan aktin e mesipërm dhe se janë dakort me sa më sipër, dhe e nënshkruan regullisht.

**PALA SHITËSE
ORION MARKU**

ORION MARKU

**PALA BLERËSE
ALTIN FURTUNA**

ALTIN FURTUNA